

Njoftim Për Shtyp Datë 4 Prill 2022



5 April, 2022 by KLGJ in NJOFTIME PËR SHTYP

Sot në datën 04 Prill 2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi mbledhjen plenare të radhës ku shqyrtoi çështjet si vijon:

Këshilli vendosi miratimin e “Komente dhe sugjerime mbi rezultatet e vlerësimit paraprak nga Shkolla e Magjistraturës të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në formimin fillestar, profili gjyqtar, për vitin akademik 2022-2023”.

Në vijim, Këshilli vendosi miratimin e listave emërore të kandidatëve që plotësojnë si dhe të atyre që nuk plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2022 – 2023, për Ndhmës Ligjorë.

KLJGJ përgjatë mbledhjes vendosi gjithashtu, caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2021, të filluar ndaj magjistrates znj. {...}, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Apelit {...}.